

VENDIM
Nr. 104, datë 10.2.2016

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË BERAT, TË PASURISË ME NR. 2953, ME SIPËRFAQE 5 670 m², NË ZONËN KADASTRALE 8505, BERAT, DHE PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 834, DATË 21.11.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË BERAT, TË QARKUT TË BERATIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Berat, të pasurisë me nr. 2953, me sipërfaqe 5 670 m², me vendndodhje në zonën kadastrale 8505, Berat, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur për zgjerimin e varrezave publike të qytetit të Beratit.

2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, t’i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme, që i bashkëlidhet vendimit nr. 834, datë 21.11.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Berat, të qarkut të Beratit”, të ndryshuar.

3. Bashkisë Berat i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryetari i Bashkisë Berat dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

2. FORMULARË PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Mbështetur në inventarin e pronave të veçanta të tipit infrastrukturë dhe shërbime publike)

Për një shtesë në listën përfundimtare të transferimit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 834, datë 21.11.2012

Bashkia/komuna: Berat

Fusha e përdorimit të pronës: Shërbime publike (varreza)

Nr. rend	A			B			C			
	Zona kadastrale dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret pronë	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
2953	8505 K-34-112-(240-A)	1260	Pyll	Pyll	5670		Shërbime publike	Bashkia Berat	Bashkia Berat	